



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT  
DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE**

Nr. 9013 prot.

Himarë, më 17.12.2025

### **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE NË NIVELIN BAZË NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Në zbatim të ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, si dhe kreu III i VKM-së nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, dhe kërkesës më nr. 6394, prot. datë 14.08.2025 të bërë nga shefi i sektorit të MZSH-së Himarë, drejtorja e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, njofton shpalljen për:

- 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin: Luftues zjarrfikës – në sektorin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (MZSH);

**Afati për dorëzimin e dokumenteve është deri më datën: 31.12.2025**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

#### **Pozicioni luftues zjarrfikës:**

1. Punonjësi zjarrfikës (luftues, shpëtues, furnizues, evakuues) është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë e të pronës.

2. Punonjësi zjarrfikës varet nga komandanti i shërbimit dhe përgjigjet për:

a) marrjen e dorëzimin e shërbimit me përgjegjësi, duke kontrolluar pajisjet personale dhe të përbashkëta të shërbimit, njofton komandantin e shërbimit për mangësitë e vërejtura dhe ndihmon për eliminimin e tyre;

b) njohjen mirë të detyrës së tij funksionale, duke u përpjekur maksimalisht për aftësimin profesional, duke qenë në çdo kohë në gatishmëri të plotë, duke ditur mirë radhën e veprimeve dhe duke vepruar me shpejtësi dhe saktësi me marrjen e sinjalit për dalje në operacion;

c) marrjen e sinjalit të alarmit, vepron me shpejtësi dhe saktësi, si dhe pajiset me mjetet e tij personale dhe mjetet e nevojshme për operacionin. Pozicionohet në vendin e tij në automjetet dhe raporton gatishmërinë e tij për lëvizje. Gjatë udhëtimit për në vendngjarje komunikon me komandantin e shërbimit për të eliminuar ndonjë mangësi të vërejtur;

ç) pozicionimin në formacion luftimi, zbatimin e detyrave dhe të urdhrave drejtuesit të operacionit (DSHZ), duke vepruar profesionalisht;

## **Kriteret për pranimin e kandidateve në shërbimin e MZSH-së:**

Kandidati për pranimin në nivelin bazë të shërbimit të MZSH-së duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë);
- Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm;
- Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm;
- Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë;
- Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist etj.

Kandidati që aplikon dhe konkurren për punonjës të nivelit të mesëm në strukturat e shërbimit të MZSH-së duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë përfunduar arsimin e lartë policor, ushtarak, juridik ose inxhinieri, niveli minimal i diplomës "Bachelor";
- c) Për sektorin e inspektim/parandalimit përzgjidhen kandidaturat që plotësojnë kriteret ligjore dhe që kanë nivelin minimal të diplomës "Bachelor" në degët inxhinieri, juridik;
- ç) Për sektorin e ndërhyrjes përzgjidhen kandidaturat, që plotësojnë kriteret ligjore dhe që kanë përfunduar arsim ushtarak, policor.
- d) Për sektorin e mbështetjes dhe të logjistikës përzgjidhen kandidatë që plotësojnë kriteret ligjore e që janë diplomuar në degët financë dhe ekonomik.
- dh) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- e) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike;
- ë) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

### **Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:**

1. Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.
2. Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathhtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.
3. Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
4. Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal.

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për vlerësimin përfundimtar. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes dhe njoftimit të rezultateve të testimit.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

